



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, më 26 shtator 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e raportit të monitorimit të subjekteve OSHMA gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023 (vendimi nr.79, datë 26.09.2023).
2. Miratimi i ndryshimeve në strukturën e pronësisë të shoqërisë “Scan” sh.a., për subjektin audioviziv “Tv Scan”, aplikim i dërguar nga shoqëria “Balfin” sh.p.k (vendimi nr.80, datë 26.09.2023).
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë “KISS FM” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat vendor “Radio Kiss FM” (vendimi nr.81, datë 26.09.2023).
4. Rinovim autorizimi, i shoqërisë “APT CABLE” sh.p.k autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor APT” (vendimi nr.82, datë 26.09.2023).

5. Caktimin e sanksionit me gjobë ndaj subjektit audioviziv “TV KLAN” për shkelje të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (vendimi nr.83, datë 26.09.2023).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 26 shtator 2023

